

Urgjenca. E gatshme për të gjithë.



**Ne qoftë se di si funksionon,
funksionon më mirë edhe për ty.**

Një shërbim i disponueshëm 24 orë në 24.

Janë më shumë se dyzet Urgjenca
në Toskanë që çdo ditë, 24 orë në 24,
janë në dispozicion të popullsisë italiane
dhe asaj të huaj, për të trajtuar
problemët shëndetësore urgjente.

Në secilën nga këto urgjencia arrijnë
çdo ditë dhjetëra e dhjetëra persona,
ndonjëherë njëkohësisht dhe me probleme
klinike të ndryshme midis tyre për rëndësi
dhe impenjim të asistencës së personelit.

Për këto motive, Urgjencia është organizuar
në hapësira dhe funksione të caktuara,
sic është salla e mirëpritjes,
salla e pritjes, zona për Triage
infermieristik dhe dhomat per vizitat
e diferencuara për nga rëndësia.
Personat që kanë nevoje për këtë Shërbim,





dhe familjarët e tyre mund të kenë besim, përsa i përket kontolleve dhe kurave, të infermierëve, mjekëve dhe personelit sanitari posaçërisht të përgatitur.

Megjithatë është e nevojshme të shkruajmë disa informacione bazë që ju lejojnë të orientoheni në këtë organizëm kompleks dhe për të njohur më në brendësi disa nga aspektet praktike që i përkasin.

Për shembull, në ç'mënyrë dhe me ç'motiv ju shënohet kodi me ngjyrë, çfarë rastesh kanë prioritetin e vizitës kundrejt rasteve të tjera, dhe kur duhet paguar për vizitën, janë disa nga treguesit që është e domosdoshme t'i njihni.

“Triage”- i infermieristik dhe ngjyrat e kodeve.

Fillon këtu, në Triage-in infermieristik, përshkrimi i diagnozës dhe i asistencës. Triage është një fjalë franceze që do të thotë seleksionim i pacientëve në bazë të shenjave dhe simptomave klinike, që janë vlerësuar duke marrë përbazë tregues që ndahen në shkallë kombëtare dhe rajonale.

Një infermier i kualifikuar mbledh motivet përfshirë të hyrë në Urgjencë, dhe nëpërmjet një bashkëbisedimi, vëzhgimi dhe paraqitjen e disa parametrave jetësore (pulsi, tensioni etj) shënon një ngjyrë përkaktor prioriteti **e hyrjes në vizitë**. Kodet janë me ngjyrë të kuqe, të verdhë, jeshile, bojqelli, të bardhë, në radhë sipas rëndësisë së urgjencës.

Kodi i Triage, jo domosdoshmërisht korrispondon me kodin final të rëndësisë klinike që përcaktohet vetëm nga mjeku, në bazë të analizave dhe vizitës klinike. Nga ky moment pacienti është i regjistruar dhe do të thirret më vonë përvizitën. Në rast se do të ndërpresë qëndrimin e tij në urgjencë, duhet t'ja komunikojë personelit sanitari të Triage.



Pacient në rrezik përfshirë jetën.

Hyrje e menjëhershme



Pacient, gjëndja e të cilit mund të bëhet kritike.

Hyrje e shpejtë




Hyrje pas kodit të kuq e të verdhë

Pacient me probleme akute me funksione jetësore në limit. Nuk parashikohet asnjë rrezik përfshirë jetën.



Hyrje pas kodit të kuq, të verdhë e jeshil

Pacient me problem akut, por të rëndësisë së lehtë.



Hyrje pas të gjithëve


Pacient me problem jo akut edhe /ose të rëndësisë së vogël.

Kush hyn i pari. Pritja

Kur shënohet një kod i bardhë ose bojqelli, është e mundur që pritja të zgjatet sepse kanë prioritet kodet e kuq, të verdhë ose jeshilë, edhe pse kanë arritur më vonë. **Hyn i pari kush ka më shumë nevojë për kurim.**

Gjatë kësaj kohe, pacienti dhe familjarët e tij (ose kush e shoqëron), mund t'i drejtohen operatorëve jo sanitare, që janë një pikë referimi në të cilën mund të mbështeten për të shkurtuar vështirësitë e mundshme të pritjes.

Por e drejta për të dhënë informacione mbi shëndetin e pacientit, i ngelet vetëm personelit mjekësor dhe infermierëve, duke respektuar tutelen e të drejtës së privatësisë mbi shëndetin e personit.





Në sallën e vizitës

Në momentin e vizitës mjeku mund të fillojë menjëherë me një trajtim dhe / ose të kërkojë, për të plotësuar quadri klinik, disa të dhëna (radiografi, TAC, analiza gjaku etj) që mund të mos janë të menjëhershme.

E rëndësishme t'i thuhet personelit mjekësor, ilaçet që merren zakonisht, sëmundjet e mundshme, alergjitetë dhe kur skadon vaksina e tetanozit (në rast traume).

Në përfundim të qëndrimit, në rast se del nga urgjencia, jepen këshilla dhe orientime për t'u thelluar me mjekun e familjes, ose përndryshe pacienti do të rrijë në një dhome të dedikuar për oservimin, vëzhgimin e kushteve klinike, ose do të shtrohet për të ndjekur analiza të mëtejshme dhe/ose terapi.

Pagesa me biletë “ticket”.

Nuk është e parashikuar pagesa e biletës për kodet e kuq, të verdhë dhe jeshil.

Kurse me një kod të **bardhë ose bojqielli**, kuota per t'u paguar është 25 euro, përfshirë këtu vlerësimet klinike dhe analiza të mundshme të laboratorit.

Kjo shifër mund të ngrihet, tek kodet e bardhë ose bojqielli, me 25 euro të tjera, në rast se janë kryer diagnostikime me mjete (radiografi, ekografi, etj).





Shërbimi i urgjencës është falas për:

- të rinjtë nën moshë 14 vjeç;
- pazientë që nuk paguajnë në bazë të normatives në fuqi;
- gratë shtatzëna;
- të gjithë ata që kanë patur një aksident në punë;
- situatat e klasifikuara me kodet e bardhë dhe bojqelli, të lidhura me helmime akute, trauma që kërkojnë qepje ose allçi, nevojë për një periudhë të shkurtër vëzhgimi në zonën e Urgjencës ose në brendësi të strukturës spitalore.

Për sugjerime dhe kritika përsa i përket këtij shërbimi shëndetsor, drejtohu në Zyrat e Mardhënieve me Publikun. Është një mënyrë për ta bërë shërbimin e Urgjencës gjithmonë e më të ngjashëm me atë që ti do të doje.